



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 873/24 Datë: 10.05.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 122-të, mbajtur me datë 22.04.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimit të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 1. *Menaxhimi i Riskut dhe Sigurimit, MSc 120, me kuotën maksimumi 25 studentë për vit akademik;*
 2. *Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm, MSc 120 me kuotën maksimumi 25 studentë për vit akademik;*
- II. Riakreditohet programi i studimit i Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 3. *Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor, MSc 120, me kuotën maksimumi 25 studentë për vit akademik;*
- III. Numri i studentëve si në paragrafin I dhe II, zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshimet e bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.

VII. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për ri/akreditimin e programeve të studimit me bartësit e programeve si në tabelë:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1.	<i>Menaxhimi i Riskut dhe Sigurimit, MSc 120</i>	Halit Shabani Ibish Mazreku Afrim Selimaj
2.	<i>Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm, MSc 120</i>	Alberta Tahiri Shyhrete Muriqi
3.	<i>Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor, MSc 120</i>	Agim Rysha Kastriot Pehlivani Astrit Bilalli

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; Menaxhimi i Riskut dhe Sigurimit, MSc 120, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Marina Gregoric, Sanja Kalambura, Domagoj Svirig dhe Marija Vasilevska është organizuar më 19.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2) dhe Substancialisht pesë (5) fusha.
2. Për programin e studimit; Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm, MSc 120 vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Marina Gregoric, Sanja Kalambura, Domagoj Svirig dhe Marija Vasilevska është organizuar më 19.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht tre (3) dhe Substancialisht katër (4) fusha.
3. Për programin e studimit; Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor, MSc 120, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Kyriaki Zinoviadou, Jasna Novak dhe Jadranka Pelikan, është organizuar më 29.02.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2) dhe Substancialisht pesë (5) standarde.


Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 122-të, të mbajtur më datë 22.04.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve

ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatim prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë